



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 156

Tiranë – E martë, 2 shtator 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 479, datë 1.9.2025	Për ngarkimin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare për paraqitjen e kërkesave për kryerjen e punimeve dhe ndjekjen e zbatimit të marrëveshjes për realizimin e projektit të rikonstruksionit dhe rikonceptimit të sallës së mbledhjeve dhe hollit të saj në mjediset e Kryeministrit.....
	20787
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 22, datë 25.8.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar.....
	20787



VENDIM

Nr. 479, datë 1.9.2025

PËR NGARKIMIN E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERTITARE PËR PARAQITJEN E KËRKESAVE PËR KRYERJEN E PUNIMEVE DHE NDJEKJEN E ZBATIMIT TË MARRËVESHJES PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË RIKONSTRUKSIONIT DHE RIKONCEPTIMIT TË SALLËS SË MBLEDHJEVE DHE HOLLIT TË SAJ NË MJEDISËT E KRYEMINISTRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare për paraqitjen e kërkesave për kryerjen e punimeve, sipas legjislacionit në fuqi, dhe ndjekjen e zbatimit të marrëveshjes së dhurimit, me objekt realizimin e projektit të rikonstruksionit dhe rikonceptimit të sallës së mbledhjeve dhe hollit të saj në mjediset e Kryeministrit.

2. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, në funksion të zbatimit të projektit dhe të marrëveshjes së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ngarkohet për kryerjen e procedurave përzgjedhëse për mbikëqyrjen dhe kolaudimin, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

UDHËZIM

Nr. 22, datë 25.8.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020, “PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, neneve 30 dhe 35 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar; vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”, të ndryshuar; dhe të urdhrin nr. 113, datë 26.3.2024, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Ana Kapaj”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimet si më poshtë:

a) Kudo në përmbajtje të udhëzimit, togfjalëshi “*Ministria e Arsimit dhe Sportit*” të zëvendësohet me togfjalëshin “*Ministria përgjegjëse për arsimin*”.

b) Pika 1 e kreut I/B ndryshon si më poshtë:

“1. Institucioni i arsimit të lartë ngarkon aplikimin në platformën e-Albania, për riorganizimin e LAL-së, sipas formularit përkatës në platformën e-Albania, brenda datës 30



dhjetor për vitin akademik pasardhës, i cili shqyrtohet në MAS”.

c) Pas kreut IV shtohet kreu IV/1, me përmbajtje si më poshtë:

**“KREU IV/1
PROCEDURA E SHQYRTIMIT TË
APLIKIMEVE DHE TË ANKIMIMEVE**

Mbi bazën e aplikimeve në platformën e-Albania, struktura përgjegjëse për lejet dhe licencat dhe struktura përgjegjëse për arsimin e lartë në ministrinë përgjegjëse për arsimin, vlerësojmë aplikimet dhe ankimmimet, sipas përgjegjësiave më poshtë:

1. Për të gjitha aplikimet e përcaktuara në këtë udhëzim, struktura përgjegjëse për lejet dhe licencat shqyrton dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti, sipas formularëve të kërkesave në e-Albania për aspektet e përputhshmërisë ligjore.

2. Për të gjitha aplikimet e përcaktuara në këtë udhëzim struktura përgjegjëse për arsimin e lartë shqyrton aspektet përmbajtjesore të cilësisë së aplikimit, që lidhen me vlerësimin mbi nevojat e tregut, përputhshmërinë e kriterëve dhe të standardeve të cilësisë, të kërkuara me ato të aplikimit. Sipas vlerësimit, struktura përgjegjëse për arsimin e lartë mund të kërkojë informacione plotësuese mbi aspekte që lidhen me aplikimin brenda afateve të përcaktuara.

3. Struktura përgjegjëse për lejet dhe licencat njofton subjektin për vlerësimin e aplikimit, pas vlerësimit të strukturës përgjegjëse për arsimin e lartë, sipas afateve të përcaktuara për secilën procedurë.

4. Struktura përgjegjëse për lejet dhe për licencat dhe struktura përgjegjëse për arsimin e lartë i propozojnë autoritetit përkatës ekspertët e jashtëm, nga lista e ASCAL-së.

5. Pas vlerësimit përfundimtar pozitiv nga ekspertët e jashtëm, struktura përgjegjëse për lejet dhe licencat dhe struktura përgjegjëse për arsimin e lartë, i propozojnë autoritetit përkatës aktin sipas aplikimit të subjektit.

6. Në rastet e paraqitjes së ankimmimeve, struktura përgjegjëse për lejet dhe licencat dhe struktura përgjegjëse për arsimin e lartë, në bashkëpunim me strukturat juridike ndjekin procedurat e shqyrtimit të ankimmimeve, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.”

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Ana Kapaj**

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë

